



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 112/02-18051
Datë 07.09.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 72 paragrafin 4 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 53 paragrafin 3 të Ligjit numër 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të formimit të Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik për zhvillimin e procedurës disiplinore me numër 01-052/01-17942 të datës 07.09.2023, me datë 07.09.2023 merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet pika 1 e vendimit me numër 01-112/02-23078 të datës 14.10.2022 për plotësimin ndryshimin e vendimit për formimin e Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik, për zhvillimin e procedurës disiplinore me numër 01-052/01-17942 të datës 07.09.2023, me qëllim të shmangies së ndonjë konflikti të interesit të mundshëm, për shkak se në shkresat e lëndës ka disa e-maile të anëtarit të komisionit z. Zymber Berisha të cilat do të elaborohen gjatë procedurës, kështu që me qëllim të mbarëvajtjes së procedurës anëtari i komisionit Zymber Berisha zëvendësohet me anëtarin Liridona Nuka, duke u formuar Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik për procedurën e lartcekur në këtë përbërje.
 - a. Musë Gjergjaj, kryesues
 - b. Teuta Krasniqi, anëtare
 - c. Hamdi Kameri, anëtar
 - d. Liridona Nuka, anëtare
 - e. Bujar Nuqi, anëtar
2. Pjesa tjetër e vendimit me numër 01-112/02-26062 të datës 04.11.2019 dhe vendimit me numër 01-112/02-23078 të datës 14.10.2022 mbetet e pa ndryshuar.

Vendimi iu dorëzohet:

- Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës